UDHËZIM
Nr.3, datë 5.10.2011

PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË OBJEKTEVE, TË NDËRTUARA ME LEJE NDËRTIMI TË PRAPAMBETURA NË BASHKINË E TIRANËS, NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, dhe të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Të gjitha objektet e ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit në njësinë vendore, Tiranë, të lëshuara në zbatim të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, apo të ligjit nr.7693, datë 6.4.1993 "Për urbanistikën" (i shfuqizuar), të cilat nuk figurojnë të regjistruara në regjistrat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi, do të regjistrohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim, në varësi të problematikës, si më poshtë vijon:

a) Objektet, për të cilat nuk është lëshuar leje shfrytëzimi, dhe pse është paraqitur kërkesë nga subjekti i interesuar pranë zyrës apo seksionit të urbanistikës së organit të qeverisjes vendore;

b) Objektet, për të cilat nuk është lëshuar leje shfrytëzimi dhe nuk është paraqitur kërkesë për leje shfrytëzimi nga subjekti i interesuar pranë zyrës apo seksionit të urbanistikës së organit të qeverisjes vendore;

c) Objektet, për të cilat është lëshuar leje shfrytëzimi, por kjo e fundit nuk rezulton të jetë përcjellë për regjistrim pranë ZRPP-së;

ç) Objektet, për të cilat është lëshuar leje shfrytëzimi dhe kjo e fundit është përcjellë për regjistrim pranë ZRPP-së.

2. "Subjekte të interesuara", në kuptim të dispozitave të këtij udhëzimi, janë:

a) Personi fizik apo juridik i përcaktuar si investitor në lejen e ndërtimit;

b) Personi fizik apo juridik, i cili paraqet një akt noterial të lidhur ndërmjet tij, në cilësinë e porositësit, dhe subjektit të përcaktuar si investitor në lejen e ndërtimit, me anë të të cilit janë marrë përsipër nga ky i fundit që, në këmbim të pagesës së një çmimi të caktuar, të ndërtojë për llogari të porositësit njësi individualisht të përcaktuara të objektit të ndërtuar me lejen përkatëse të ndërtimit;

c) Personi fizik apo juridik, në pronësi të të cilit figuron i regjistruar trualli, i cili përbën sheshin e ndërtimit mbi të cilin është ngritur objekti me leje ndërtimi.

3. Identifikimi i rasteve të përcaktuara në pikën 1 të kreut I të këtij udhëzimi, të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, do të kryhet nga:

a) Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, për rastet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij kreu;

b) ZRPP-ja dhe Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, për rastet e përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij kreu;

c) ZRPP-ja, për rastet e përcaktuara në shkronjën "ç" të pikës 1 të këtij kreu.

KREU II
REGJISTRIMI I OBJEKTEVE PËR TË CILAT NUK ËSHTË LËSHUAR LEJE SHFRYTËZIMI

1. Në rastet kur Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, konstaton se për objektet, për të cilat janë lëshuar leje ndërtimi, janë paraqitur kërkesa për lëshimin e lejeve të shfrytëzimit dhe këto të fundit nuk rezultojnë të jenë lëshuar, do të procedohet, si më poshtë vijon:

a) Kur konstatohet se kërkesa për leje shfrytëzimi nuk është trajtuar për mungesë të dokumentacionit që vërteton kryerjen e pagesave të taksave apo tatimeve për objektin, Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, vijon procedurat e lëshimit të lejes së shfrytëzimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për detyrimet e papaguara të objektit;

b) Kur konstatohet se kërkesa për leje shfrytëzimi nuk është trajtuar për shkak të shkeljeve të kondicioneve të lejes së ndërtimit dhe dosja nuk është përcjellë pranë ALUIZNI-t, e përcjell atë pranë këtij institucioni duke njoftuar subjektet e interesuara. ALUIZNI, kur konstaton se objekti është vetëdeklaruar brenda afateve ligjore dhe disponon aktin e vetëdeklarimit, procedon në përputhje me ligjin nr.9482,datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave informale", të ndryshuar. Në të gjitha rastet kur objektet nuk janë vetëdeklaruar në afat, ALUIZNI mban detyrimin t'ia kthejë pa veprim dosjet përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve Drejtorisë së Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, duke njoftuar dhe subjektet e interesuara.

1.1 Pas lëshimit të lejes së shfrytëzimit sipas shkronjës "a" të pikës 1 të kreut II, Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, ia përcjell atë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, së bashku me dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Lejen e sheshit të ndërtimit;
- Lejen e ndërtimit;
- Aktin e kolaudimit;
- Planvendosjen e objektit;
- Dokumente të tjera që individualizojnë njësitë e objektit të ndërtuar (projekt, planimetritë e kateve etj.);
- Aktet noteriale të lidhura ndërmjet porositësve dhe subjektit të përcaktuar si investitor në lejen e ndërtimit, të paraqitura nga subjektet e interesuara;
- Kontratat e sipërmarrjes, të lidhura ndërmjet pronarëve të truallit dhe investitorit, nëse ka.

1.2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pas administrimit të dokumentacionit të përcjellë sipas pikës 1.1 të këtij kreu, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim të çdonjërit prej subjekteve të interesuara, bën regjistrimin e objektit sipas aktit të kolaudimit, për të cilin është lëshuar leja e shfrytëzimit.

1.3 Regjistrimi i pronësisë së njësive të individualizuara, pjesë përbërëse të objektit, do të bëhet në rastet e mëposhtme:

1.3.1 Kur ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, i cili individualizon pasuritë, që do të përfitojë pronari i truallit nga marrëveshja me investitorin, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Pasuritë e individualizuara në akt noterial regjistrohen në pronësi të pronarit të truallit;

b) Pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve porositëse dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, regjistrohen në pronësi të porositësit. Mosmarrëveshjet ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhen në gjykatë. Në rast se

ka konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me procedurat e ligjit që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme, deri në përfundimin e konfliktit gjyqësor. Në rast se nuk ka konflikt gjyqësor, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme;

c) Pasuritë e individualizuara sipas aktit të kolaudimit, të cilat nuk janë regjistruara sipas shkronjave “a” dhe “b”, do të regjistrohen në pronësi të investitorit;

ç) ZRPP-ja lëshon certifikatën e pronësisë sipas përcaktimeve në aktin noterial, pasi verifikon elementet e formës dhe të përmbajtjes sipas udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Në rastet e parashikuara nga shkronja “b”, e kësaj pike, certifikata lëshohet pasi verifikohet, gjithashtu, sipas rastit, edhe përmbushja e kushtit të parashikuar nga paragrafi i dytë i shkronjës “b”, ose përmbushja e afatit të parashikuar nga paragrafi i tretë i së njëjtës shkronjë.

1.3.2 Kur ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, i cili përcakton përqindjen që do të përfitojë pronari i truallit në objekt, por nuk individualizon pasuritë që do të përfitojë ky i fundit nga marrëveshja me investitorin, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Procedohet me regjistrimin e të gjitha pasurive të individualizuara që përbëjnë këtë objekt, në bashkëpronësi të investitorit dhe pronarit të truallit, sipas pjesës në përqindje të përcaktuar në aktin noterial.

b) Për pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet porositësve dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, në kartelën/regjistrin e pasurisë së regjistruar tashmë në bashkëpronësi sipas shkronjës “a”, bëhet shënimi i ekzistencës së aktit noterial të lidhur ndërmjet subjektit porositës dhe investitorit. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhet në gjykatë. Deri në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pasuria mbetet e regjistruar në bashkëpronësi të investitorit dhe pronarit të truallit me kufizimin e veprimeve mbi pasurinë.

1.3.3 Kur pronarët e regjistruar të truallit, në momentin e paraqitjes së akteve për regjistrimin e objektit, janë të ndryshëm pjesërisht ose plotësisht nga pronarët e truallit, me të cilët investitori ka marrëveshje për ndërtimin, regjistrimi i objektit do të kryhet sipas procedurave të parashikuara respektivisht në pikën 1.3.1 apo 1.3.2 të kreut II të këtij udhëzimi, por pjesa në përqindje apo pasuritë individualisht të përcaktuara të objektit, që u takojnë pronarëve të truallit, do të regjistrohet në pronësi të pronarëve të truallit që rezultojnë si të tillë në momentin e paraqitjes së akteve për regjistrimin e objektit.

1.3.4 Kur nuk ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, por trualli ku është ngritur objekti rezulton në pronësi private, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Objekti regjistrohet në një kartelë/regjistër, duke bërë shënimin në të se ky objekt është ngritur mbi një pasuri truall në pronësi të një subjekti të ndryshëm nga investitori apo me të cilin investitori nuk ka marrëveshje për ndërtimin. Shënimi për ekzistencën e objektit mbi truallin bëhet edhe në kartelën/regjistrin e truallit, duke njoftuar pronarin e truallit, nëse figuron i regjistruar, për këtë fakt. Ky shënim bëhet edhe në kartelat/regjistrat e njësive të individualizuara që përbëjnë objektin.

b) Pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve porositëse dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, regjistrohen në pronësi të porositësit. Mosmarrëveshjet ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhen në gjykatë. Në rast se ka konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me procedurat e ligjit që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e konfliktit gjyqësor. Në rast se nuk ka konflikt gjyqësor, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme;

c) Pasuritë e individualizuara sipas aktit të kolaudimit, të cilat nuk janë regjistruar sipas shkronjave “a” dhe “b”, do të regjistrohen në pronësi të investitorit;

ç) ZRPP-ja lëshon certifikatën e pronësisë sipas përcaktimeve në aktin noterial, pasi verifikon elementet e formës dhe të përmbajtjes sipas udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Në rastet e parashikuara nga shkronja “b” e kësaj pike, certifikata lëshohet pasi verifikohet gjithashtu, sipas rastit, edhe përmbushja e kushtit të parashikuar nga paragrafi i dytë i shkronjës “b” ose përmbushja e afatit të parashikuar nga paragrafi i tretë i së njëjtës shkronjë.

1.3.5 Kur nuk ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, por trualli ku është ngritur objekti rezulton në pronësi shtetërore, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Objekti regjistrohet në një kartelë/regjistër, duke bërë shënimin në të se ky objekt është ngritur mbi një pasuri truall, në pronësi të shtetit. Shënimi për ekzistencën e objektit mbi truallin në pronësi shtetërore bëhet edhe në kartelën/regjistrin e truallit, duke njoftuar Avokaturën e Shtetit për këtë fakt. Ky shënim bëhet edhe në kartelat/regjistrat e njësive të individualizuara që përbëjnë objektin. Në rast se nuk ka një kartelë të veçantë ku rezulton i regjistruar trualli në pronësi shtetërore, ZRPP-ja procedon me regjistrimin e tij.

b) Pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve porositëse dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, regjistrohen në pronësi të porositësit. Mosmarrëveshjet ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhen në gjykatë. Në rast se ka konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me procedurat e ligjit që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e konfliktit gjyqësor. Në rast se nuk ka konflikt gjyqësor, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme;

c) Pasuritë e individualizuara sipas aktit të kolaudimit, të cilat nuk janë të regjistruara sipas shkronjës “b”, do të regjistrohen në pronësi të investitorit dhe do të kufizohen deri në paraqitjen e një akti të fitimit të pronësisë mbi truallin ku është ngritur ndërtimi. Ky kufizim nuk i shtrin efektet për veprimet mbi pasuritë e regjistruara në favor të porositësve.

ç) ZRPP-ja lëshon certifikatën e pronësisë sipas përcaktimeve në aktin noterial, pasi verifikon elementet e formës dhe të përmbajtjes sipas udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Në rastet e parashikuara nga shkronja “b” e kësaj pike, certifikata lëshohet pasi verifikohet, gjithashtu, sipas rastit, edhe përmbushja e kushtit të parashikuar nga paragrafi i dytë i shkronjës “b”, ose përmbushja e afatit të parashikuar nga paragrafi i tretë i së njëjtës shkronjë.

1.3.6 Kur trualli ku është ngritur objekti është në pronësi të investitorit, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve/porositësve dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, regjistrohen në pronësi të porositësit. Mosmarrëveshjet ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhen në gjykatë. Në rast se ka konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me procedurat e ligjit që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e konfliktit gjyqësor. Në rast se nuk ka konflikt gjyqësor, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

b) Pasuritë e individualizuara sipas aktit të kolaudimit, të cilat do të rezultojnë si të tilla pas regjistrimeve të kryera sipas shkronjës “a”, do të regjistrohen në pronësi të investitorit.

c) ZRPP-ja lëshon certifikatën e pronësisë sipas përcaktimeve në aktin noterial, pasi verifikon elementet e formës dhe të përmbajtjes sipas udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Në rastet e parashikuara nga shkronja “a” e kësaj pike, certifikata lëshohet pasi verifikohet gjithashtu, sipas rastit, edhe përmbushja e kushtit të parashikuar nga paragrafi i dytë, i shkronjës “a”, ose përmbushja e afatit të parashikuar nga paragrafi i tretë i së njëjtës shkronjë.

1.3.7 Në rastet kur për një pasuri të individualizuar të objektit janë paraqitur për regjistrim dy ose më shumë akte noteriale të lidhura ndërmjet investitorit dhe subjekteve të ndryshme porositëse apo me pronarët e truallit, ZRPP-ja do të zbatojë përcaktimet e bëra në nenin 10 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

2. Në rastet kur Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, konstaton se për objektet, për të cilat janë lëshuar lejet e ndërtimit, nuk janë paraqitur kërkesat për lëshim të lejes së shfrytëzimit, njofton subjektin e përcaktuar si investitor në lejen e ndërtimit për paraqitjen e dokumentacionit të parashikuar në nenet 11 dhe 12 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e organeve të qeverisjes vendore”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

2.1 Në rastin kur brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, paraqitet kërkesë nga subjekti investitor, kjo kërkesë trajtohet sipas parashikimeve të bëra në pikën 1 të kreut II të këtij udhëzimi.

2.2 Në rastin kur nga subjekti investitor nuk paraqitet kërkesë sipas pikës 2 të këtij kreu, Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, kryesisht apo me kërkesë të subjekteve të interesuara, verifikon dokumentacionin e administruar në dosjen e lejes së ndërtimit.

2.2.1 Kur nga verifikimi konstatohet se në dosjen e objektit ndodhet i administruar dokumenti i nevojshëm për lëshimin e lejes së shfrytëzimit, por mungon dokumentacioni i cili vërteton pagesat e detyrimeve tatimore për objektin, Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, vijon procedurat për lëshimin e lejes së shfrytëzimit dhe dërgimit të saj në ZRPP sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1 shkronja “a”, dhe 1.1 të kreut II, ndërsa ZRPP-ja procedon me regjistrimin sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1.2 dhe 1.3 të kreut II të këtij udhëzimi.

2.2.2 Kur nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së lejes së ndërtimit konstatohet se objekti nuk mund të trajtohet me lëshim të lejes së shfrytëzimit për shkak të mungesës së aktit të kolaudimit, Drejtoria e Urbanistikës, në bashkinë e Tiranës, zgjidh çështjen e kolaudimit të objektit dhe përcakton personat e autorizuar për përgatitjen e këtij akti sipas përcaktimeve të bëra në nenin 12 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

2.2.3 ALUIZNI dhe Enti Kombëtar i Banesave kanë detyrimin të mbështesin Drejtorinë e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, me të gjitha kapacitetet e tyre administrative për realizimin e parashikimeve të bëra në pikën 2.2.2., të këtij kreu.

KREU III
REGJISTRIMI I OBJEKTEVE PËR TË CILAT ËSHTË LËSHUAR LEJE SHFRYTËZIMI

1. Në rastet kur Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, konstaton se për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi janë lëshuar lejet e shfrytëzimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga ky konstatim, informon Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke përcjellë te kjo e fundit një kopje të lejes së shfrytëzimit dhe një kopje të lejes së sheshit të ndërtimit.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e administrimit të lejeve të shfrytëzimit dhe të lejes së sheshit të ndërtimit, verifikon nëse objektet, për të cilat janë lëshuar leje shfrytëzimi, janë të regjistruara. Kur konstaton se objekti, për të cilin është lëshuar leja e shfrytëzimit, nuk është regjistruar dhe dokumentacioni, që i përket këtij objekti, nuk ndodhet i administruar në ZRPP, i kërkon Drejtorisë së Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, përcjelljen e dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.1 të kreut II të këtij udhëzimi. ZRPP-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e administrimit të këtij dokumentacioni, vijon procedurat për regjistrimin e objektit sipas parashikimeve të bëra në pikat 1.2 dhe 1.3 të

kreut II të këtij udhëzimi.

3. Në rastet kur ZRPP-ja konstaton se lejet e shfrytëzimit ndodhen të administruara në ZRPP, por nuk rezulton të jetë kryer regjistrimi i objekteve, për të cilat ato janë lëshuar, procedon, si më poshtë vijon:

a) Vijon procedurat e regjistrimit të objektit kur konstaton se ndodhet i administruar i gjithë dokumentacioni i parashikuar në pikën 1.1 të kreut II të këtij udhëzimi, referuar lejes së shfrytëzimit dhe aktit të kolaudimit, sipas parashikimeve të bëra në pikat 1.2 dhe 1.3 të kreut II të këtij udhëzimi.

b) Kur konstaton se mungon çdonjëri prej dokumenteve të parashikuara në pikën 1.1 të kreut II të këtij udhëzimi, brenda 5 (pesë) ditëve nga ky konstatim i kërkon zyrës/seksionit të urbanistikës përcjelljen e këtij dokumentacioni. Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e administrimit të kërkesës së ZRPP-së, ia dërgon kësaj të fundit dokumentacionin e kërkuar. Me administrimin e këtij dokumentacioni, ZRPP-ja vijon menjëherë procedurat e regjistrimit të objektit sipas parashikimeve të bëra në pikat 1.2 dhe 1.3 të kreut II të këtij udhëzimi.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Identifikimi i rasteve të përcaktuara në pikën 1 të kreut I të këtij udhëzimi, do të bëhet nga subjektet e përcaktuara në pikën 3 të kreut I, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

2. Në të gjitha rastet e mosparaqitjes së dokumentacionit të nevojshëm nga investitori për lëshimin e lejes së shfrytëzimit për objektet, për të cilat janë lëshuar lejet e ndërtimit, pas njoftimit të kryer nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, sipas parashikimit të pikës 2 të kreut II të këtij udhëzimi, kjo e fundit, brenda 5 (pesë) ditëve nga kalimi i afatit, njofton organet e tatim - taksave për detyrimin financiar që këto subjekte i detyrohen shtetit me qëllim përmbushjen e tyre sipas parashikimeve ligjore.

3. Ngarkohen kryetari i Bashkisë së Tiranës, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, Drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha